MAL BERISHA – ART DHE KULTURË BORIZANË – KRUJË, 16 GUSHT 1975.

ATY NISI RRUGA IME...DHE SOT, KUJTIMET FLASIN MË FORT SE MURET.

Plot 50 vjet më parë, më 16 gusht 1975, fillova punë në Shtëpinë e Kulturës së fshatit Borizanë, në rrethin e Krujës. Isha djalë i ri dhe sapo kisha përfunduar studimet. Pallati i Kulturës, në atë kohë thuajse i përfunduar, u bë një qendër e bukur – sado propagandistike, por njëkohësisht edhe emancipuese – për tërë atë zonë.

Në kujtim të asaj dite të 16 gushtit 1975, u ktheva për të risjellë në mendje vitet e punës në atë fshat. Ato vite i mbaj mend me respekt për shumëçka, por dua të harroj ato që ia bënin jetën njeriut të lodhshme, të rëndë e shpeshherë të padurueshme...”

Bëra një foto të ndërtesës së Pallatit të Kulturës, e cila dikur ishte shumë e bukur, por sot është shndërruar në modelin më të frikshëm të shëmtisë urbane. Për të mos e frustruar shikuesin e këtij statusi, e përpunova fotografinë me inteligjencë artificiale, e cila arriti të ruajë thuajse 70% të kontureve dhe formës fillestare të ndërtesës. Këto foto po i sjell këtu, së bashku me një tjetër që realizova po aty me kolegun, mikun dhe bashkëpunëtorin tim të parë, muzikantin Mustafa Rryci të cilin e gjeta pikërisht aty, e që mbetëm përgjithmonë të lidhur në kujtesë dhe respekt.